



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK
DHE SIGURINË KIBERNETIKE

Nr. 919 Prot.

Tiranë më 13.11.2023

UDHËZIM

Nr. 2 datë 13.11.2023

“Për disa ndryshime në udhëzimin nr.1, datë 15.03.2023 “Mbi përfundimin e aktivitetit të ofruesit të kualifikuar të shërbimit të besuar dhe transferimin e shërbimit””

Në mbështetje të ligjit nr.9880, datë 25.2.2008 “Për nënshkrimin elektronik” i ndryshuar, ligjit nr.107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.69, datë 27.01.2016 “Për miratimin e rregullores për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike

UDHËZON:

1. Në udhëzimin nr.1, datë 15.03.2023 “Mbi përfundimin e aktivitetit të ofruesit të kualifikuar të shërbimit të besuar dhe transferimin e shërbimit” të bëhen ndryshimet si vijon:
 - 1.1. Pika 1 të ndryshohet me përmbajtjen si vijon:

*“1.Verifikon planet përfundimtare të aktivitetit në rastet kur ofruesi i kualifikuar i shërbimit të besuar ndërpret aktivitetin duke përfshirë:
Mënyrën se si informacioni mbahet i aksesueshëm për një periudhë të paktën 7 vjeçare pas përfundimit të vlefshmërisë së certifikates me qëllim përdorimin e tyre si provë në procedura ligjore, si dhe për të siguruar vazhdimësinë e shërbimit.”*
 - 1.2. Pika 3 të ndryshohet me përmbajtjen si vijon:

*“3.Në rastet e transferimit të shërbimeve të besuara tek palët e treta, kur kjo e fundit nuk ka statusin e “kualifikuar”, autoriteti merr në shqyrtim dokumentacionin e nevojshëm për dhënien e statusit “i kualifikuar” për një periudhë 3 mujore nga aplikimi. Në qoftë se nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se nevojiten informacione shtesë nga OSHB, autoriteti zgjat afatin e shqyrtimit të dokumentacionit edhe për 30 ditë të tjera.
Autoriteti jep statusin i kualifikuar në përfundim të afatit 3 mujor nëse nga shqyrtimi rezulton se nuk ka nevojë për dokumentacion shtesë ose në përfundim të periudhës shtesë 30 ditore kur dokumentacioni përmbush kërkesat e akteve ligjore e nënligjore në fuqi.*

1.3 Pika 4 e seksionit “Detyrat e OKSHB kur ndërpret veprimtarinë ose e transferon shërbimin tek një OKSHB tjetër” të ndryshohet me përmbajtjen si vijon:

“4.OKSHB regjistrojnë dhe mban të aksesueshme për një periudhë të paktën 7 vjeçare pas përfundimit të vlefshmërisë së certifikatës, të gjithë informacionin relevant mbi të dhënat e lëshuara dhe të mbledhura, me qëllim përdorimin e tyre në procedura ligjore, si dhe për të siguruar vazhdimësinë e shërbimit kur e transferon tek një OKSHB tjetër. Një regjistër i tillë mund të mbahet në mënyrë elektronike”.

1.4 Paragrafi i parë i seksionit “Detyrat e subjektit të ri të cilit i transferohet shërbimi” të ndryshohet si më poshtë vijon:

“Subjekti i ri i cili nuk e ka statusin i “kualifikuar” duhet të nënshtrohet procesit të marrjes së statusit “të kualifikuar” për ushtrimin e veprimtarisë si OKSHB, proces i cili duhet të ndërmerret përpara ofrimit të shërbimit të besuar”.

2. Ngarkohet Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike për zbatimin e këtij udhëzimi.
3. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

IGLI Tafa

